



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
**Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice**  
Kabineti i Ministres-Kancelarija Ministra-Cabinet of the Minister

Nr. 28/2025  
Datë: 27/01/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, nr. 7, 01 mars 2019), nenin 8 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4) të Rregullores nr. 02/2021 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, në përputhje me nenin 3 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15.4) dhe nenin 4 të Ligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike, si dhe në përputhje me nenin 7 dhe 8 të Rregullores nr. 01/2019 menaxhimin financiar dhe kontrollin, Ministria e Drejtësisë si udhëheqëse e sektorit të subjektit publik (SSP), nxjerr:

**V E N D I M**

**Për delegimin e autorizimeve për zyrtar autorizues për menaxhimin e buxhetit, shpenzimeve dhe pasurisë**

1. Ministria e Drejtësisë – Anita Kalanderi, Sekretare e Përgjithshme
2. Agjencitë Ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, si në vijim:
  - 2.1 Shërbimi Korrektues i Kosovës – Ismail Dibrani, Drejtor i Përgjithshëm;
  - 2.2 Shërbimi Sprovues i Kosovës – Arsim Tahiri, Drejtor i Përgjithshëm;
  - 2.3 Instituti i Mjekësisë Ligjore – Ditor Haliti, Zv. Drejtor i Përgjithshëm;
  - 2.4 Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar – Fadil Bunjaku, U.D. Drejtor i Përgjithshëm;
  - 2.5 Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë – Muamer Bikliqi, Zv. Kryeinspektor;
  - 2.6 Avokatura Shtetërore – Arsim Zuka, Zv. Avokat i Përgjithshëm Shtetëror
  - 2.7 Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Faton Jashari, U.D. Drejtor Ekzekutiv
3. Zyrtarët e përcaktuar në paragrafin 1 dhe 2 të këtij vendimi tek të cilët janë deleguar autorizimet, janë të obliguar që të veprojnë në harmoni me Ligjin përkatës mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin përkatës të Buxhetit, Ligjin përkatës të Prokurimit dhe dispozitat tjera përkatëse dhe të delegojnë autorizimet për menaxhimin financiar dhe kontrollin zyrtarëve përkatës të tyre.

4. Zyrtarët autorizues, të cilëve ju janë deleguar autorizimet, përveç autorizimeve sipas paragrafit 3, ju delegohen të gjitha autorizimet për menaxhimin e pasurisë jo financiare sipas Rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo Financiare, neni 4, (pika 1, 2, 3 dhe 4), që të menaxhojnë pasurinë jo financiare për departamentet/divizionet/sektorët/programet të cilat i udhëheqin, në të gjitha aspektet, duke filluar nga autorizimi, pranimi, dhënia në shfrytëzim, kujdesi, mbajtja e evidencës, regjistrimi, vlerësimi pas amortizimit ekonomik apo shlyerjajtjetërsimi. Të gjitha veprimet, duhet të merren sipas ligjeve dhe rregulloreve të cilat janë në fuqi.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Albulena HAXHIU

Ministre e Drejtësisë

*Vendimi i dërgohet:*

- *Të lartpërmendurve;*
- *Kabinetit të Ministres;*
- *Zyrës së Sekretares të Përgjithshëm;*
- *Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;*
- *Departamenti për Buxhet dhe Financa;*
- *Divizionit për Prokurim Publik;*
- *Arkivit të MD-së.*